



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.346/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Fejzullah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.346/2017 e datës 22.10.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren.

A r s y e t i m

Më datën 22.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga organizata BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se në Qendrën e Votimit me numër 2033A në shkollën fillore “ Dëshmorët e Zhurit” në fshatin Zhur, gjatë gjithë ditës në një afërsi më afër se 100 metra me shkollën, ka qenë i vendosur posteri i LDK-së, i varur mbi rrugë publike me fotografitë e Hatim Baxhakut, kandidat për kryetar të Komunës së Prizrenit nga LDK me numër 47 dhe Behar Begaj, kandidat për Kuvend Komunal me numër 16. Parashtruesi i ankesës thekson se veprimi i tillë në ditën e zgjedhjeve bie ndesh me nenin 36 par.1 pika a) dhe b) dhe nenin 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, është e parregullt sepse nuk është e nënshkruar nga organizata BIRN dhe Internews Kosova dhe si tillë ankesa nuk i plotëson kushtet sië kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015, të PZAP-it dhe në bazë të nenit 118 të LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshtënuar e në mbeshtetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.346/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.